

L I G J
Nr.8008, datë 5.10.1995

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7710, DATË 18.5.1993 “PËR NDIHMËN DHE PËRKUJDESJEN SHOQËRORE”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7886, DATË 8.12.1994

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror”, ndryshuar me ligjin nr.7886, datë 8.12.1994, bëhen këto ndryshime:

Në nenin 3, pika 1 ndryshohet si vijon:

“Termi “familje” nënkupton marrëdhëniet bashkëshortore, marrëdhëniet prindër-fëmijë dhe marrëdhëniet e kujdestarisë të personave që jetojnë në të njëjtën strehë”.

Në nenin 3, pika 2 ndryshohet si vijon:

“Termi “familja e madhe” nënkupton familjen me më shumë se shtatë anëtarë”.

Në nenin 3, pika 3 ndryshohet si vijon:

“Termi “vendbanim” nënkupton vendin ku familja jeton në mënyrë të vazhdueshme sipas regjistrimit në gjendjen civile. Çdo familje ka vetëm një vendbanim”.

Në nenin 3 pika 10 ndryshohet si vijon:

“Termi “pagesa nga mbrojtja sociale” përfshin të gjitha llojet e pagesave me para në dorë ose ndihmë në forma të tjera nga mbrojtja sociale, pavarësisht nga shkaku për të cilën janë dhënë, si dhe nga forma e sistemi me të cilin janë paguar”.

Në nenin 3, pika 11 ndryshohet si vijon:

“Termi “kapital” nënkupton çdo lloj prone që siguron të ardhura”.

Në nenin 3 pika 12 ndryshohet si vijon:

“Termi “veprim i qëllimshëm” nënkupton çdo veprim që synon shmangien e punësimit të shpërblyer, kualifikimit për punësim dhe për mundësi punësimi. “Veprimi i qëllimshëm” përfshin edhe mospranimin e trajtimit mjekësor të duhur në rastet e përdorimit të drogës, ose me tepricë të alkoolit, dhurime me qëllim spekulativ, disinformim të kushteve ekonomike reale të familjes, ndarjet spekulative të familjeve që vërtetohet se kanë të njëjtën strehë me qëllim përfitimi, mospërdorimin e kapitalit atje ku ekziston mundësia ose përdorimin e tij jo për nevoja të domosdoshme jetese. Ministria nxjerr udhëzime në zbatim të këtij neni”.

Në nenin 3 shtohet pika 18 si vijon:

“Termi “mbrojtja soeciale” përfshin të gjitha llojet e mbrojtjes sociale të siguruar nga shteti ose nga vetë individi, si dhe ndonjë sistem tjetër mbrojtjeje”.

Në nenin 3, pas pikës 18, shtohet pika 19 si vijon:

“Termi “familje bujqësore” nënkupton familjen që ka tokë në përdorim a pronësi, pavarësisht nga vendndodhja e familjes dhe e tokës”.

Në nenin 3, pas pikës 19, shtohet pika 20 si vijon:

“Termi “ministra” nënkupton “Ministrinë e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë”.

Neni 4 ndryshohet si vijon:

“ Ndihma ekonomike u jepet familjeve të shtetasve shqiptarë që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose nuk kanë të ardhura materiale jetese nga:

- a) veprimtaria ekonomike;
- b) mbrojtja shoqërore ose ndonjë sistem tjetër mbrojtjeje;
- c) kapital;

ç) anëtar të familjes jashtë shtetit”.

Neni 6 ndryshohet si vijon:

“Familjes bujqësore i jepet ndihmë ekonomike e pjesshme për të plotësuar të ardhurat e saj të pamjaftueshme nga:

- a) toka;
- b) bagëtia;
- c) kafshët dhe shpendët;
- ç) nga vreshtat, kopshtaria dhe mbajtja e bletëve;
- d) të ardhurat e përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji”.

Në nenin 7 pika 2 ndryshohet si vijon:

“Masa e ndihmës ekonomike mujore për familjen në komunë dhe në bashki vendoset nga këshillat e bashkisë e të komunës. Për përcaktimin e masës së ndihmës ekonomike për secilën familje, këshilli i bashkisë e komunës merr në konsideratë:

- a) fondin e bllokndihmës së akorduar nga ministria;
- b) vendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me kriteret e familjeve që nuk kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë ekonomike;

c) kriteret specifike të këshillave të përcaktuara për këtë qëllim në secilën bashki a komunë.

Masa e ndihmës ekonomike mujore e që u akordohet familjeve, nuk mund të jetë më e madhe se 100 për qind e nivelit maksimal të ndihmës ekonomike të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave”.

Në nenin 7 pika 3 ndryshohet si vijon:

“Vendimi për përcaktimin e nivelit të nevojave, të të ardhurave dhe të treguesve për përshtatshmërinë dhe masën e bllokndihmës nxirret nga Këshilli i Ministrave, sipas rekomandimit të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve politikë. Në vendim Këshilli i Ministrave përcakton të ardhurën që merret në konsideratë për përcaktimin e masës së ndihmës ekonomike”.

Në nenin 7, pas pikës 3, shtohet pika 4 si vijon:

“Këshilli i Bashkisë dhe i Komunës kanë të drejtë të përcaktojnë kriteret specifikë për ndarjen e bllokndihmës në njësinë e tyre. Por këto kriteret të mos jenë në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe të mos kalojnë shumën e parave të akorduara për këtë qëllim”.

Në nenin 16 pika 1 ndryshohet si vijon:

“1. Sistemet publike të asistencës sociale dhe të përkujdesit shoqëror administrohen nga këshillat e bashkive dhe të komunave.

2. Këshilli i bashkisë dhe i komunës vendos për:

a) masën e ndihmës ekonomike të paktën një herë në muaj, mbi bazën e propozimit të bërë nga administratori shoqëror;

b) kryefamiljarin e individin që do të marrë ndihmë ekonomike të plotë ose të pjesshme;

c) masën mujore të ndihmës ekonomike për secilën familje;

ç) kthimin e parave për rastet e përfitimit mujor të padrejtë të ndihmës ekonomike mujore;

d) masën e gjobës për veprime të qëllimshme dhe informacioni të pasaktë.

3. Këshilli i bashkisë a komunës është përgjegjës para Këshillit të Ministrave për:

a) përdorimin e fondit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi;

b) sigurimin e mbrojtjes shoqërore të përcaktuar sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) zbatimin dhe marrjen në konsideratë të rekomandimeve të bëra nga inspektorët e ndihmës ekonomike.

4. Këshilli ka për detyrë:

a) të pranojë të gjitha kërkesat për ndihmë ekonomike;

b) të sqarojë familjet pretenduese për ndihmë ekonomike, të cilave u është refuzuar dhënia e saj deri 30 ditë pas marrjes së ankesës, me qëllim që ato të vazhdojnë rrugën e ankimit.

5. Kryetari i bashkisë apo komunës është përgjegjës para Këshillit të Ministrave për:

a) dërgimin në kohë dhe me saktësi të informacionit të nevojshëm të kërkuar nga ministria;

b) zbatimin dhe marrjen në konsideratë të propozimeve të bëra dhe detyrave të lëna nga inspektorët e ndihmës ekonomike.”

Pas nenit 18 shtohet neni 18/a me këtë përmbajtje:

“Sanksionet e ndihmës ekonomike në bashki e komuna janë përgjegjëse përpara kryetarit të

bashkisë dhe të komunës. Ministria harton legjislacionin, vendimet dhe udhëzimet për zbatimin e legjislacionit dhe përgjigjet për kualifikimin e punonjësve sociale”.

Në nenin 22 pika 4 ndryshohet si vijon:

“Ministria studion varfërinë dhe përcakton nivelet e minimumit jetik”.

Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Në zbatim të këtij ligji, ministria krijon administratën e ndihmës ekonomike e të përkujdesit shoqëror të drejtuar nga drejtori i përgjithshëm, i cili emërohet nga Këshilli i Ministrave dhe është përgjegjës para ministrit. Detyrat e kësaj administrate, organizimi dhe rregullat për financimin e saj përcaktohen me statut të propozuar nga ministri dhe të miratuar nga Këshilli i Ministrave”.

Në nenin 24 shtohet pika 4 si vijon:

“Inspektorët kanë të drejtën për të kërkuar dhe përgjegjësinë, për të verifikuar saktësinë e të dhënave të kërkuara nga ministria për përcaktimin, ndarjen e bllokndihmave dhe shpërndarjen e ndihmës prej këshillave.

Insektorët detyrohen të paraqesin pranë prefekturës çdo muaj, materialin përmbledhës të rezultateve të inspektimeve të kryera, në të cilin evidentohen të gjitha shkeljet e bëra nga këshillat e pushtetit lokal dhe nga administrata lokale gjatë zbatimit të akteve ligjore e nënligjore për ndihmën e përkujdesjen shoqërore.

Prefektura vendos për masat që duhet të merren në lidhje me shkeljet e konstatuara.

Neni 25 ndryshohet si vijon:

“1. Ndihma ekonomike financohet nëpërmjet:

- a) bllokndihmës së buxhetit të shtetit;
- b) fondeve të buxhetit lokal;
- c) fondeve të buxheteve të organizmave joqeveritare.

2. Bllokndihma për secilën bashki e komunë vendoset nga ministria, duke marrë në konsideratë:

- a) strukturën e popullsisë sipas moshës, shëndetit dhe seksit;
- b) strukturën dhe shkallën e punësimit, vetëpunësimit dhe papunësisë;
- c) strukturën e të ardhurave materiale, duke përfshirë të ardhurat e të gjitha burimeve të përgjithshme në popullsi;
- ç) kapitalet e të tjera prona private;
- d) pronësinë e përdorimin e tokës, rritjen e mbajtjen e kafshëve dhe të ardhurat nga bujqësia;
- dh) të dhënat për nënushqyerjen e popullsisë;
- e) rezultatet e inspektimeve dhe abuzimet e verifikuara nga inspektimet.

3. Këshilli i bashkisë a komunës lejohet të përdorë deri në 50 për qind të fondit të kursyer të ndihmës për zhvillimin e bashkisë a komunës, për punësimin e anëtarëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, si edhe zbut varfërinë. Kriteret e përdorimit të fondeve të kursyera përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Propozimi për zhvillimin e bashkisë a komunës bëhet nga vetë njësitë administrative dhe miratohet nga Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal”.

Neni 26, pika 1 ndryshohet si vijon:

“Ndihma ekonomike jepet pasi bëhet kërkesa me shkrim nga kryetari i familjes. Kërkesa nënshkruhet nga gjithë anëtarët madhorë të familjes. Kërkesa për ndihmë ekonomike paraqitet në seksionin përkatës të bashkisë a komunës ku familja ka vendbanimin”.

Në nenin 26, pika 3 ndryshohet si vijon:

“Dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e ndihmës ekonomike, i paraqitur nga kryefamiljari, përcaktohet nga ministria”.

Neni 2

Në zbatim të këtij ligji Këshilli i Ministrave nxjerr vendimet, kurse ministria udhëzimet përkatëse.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më 15 tetor.

Shpallur me dekretin nr.1261, datë 30.10.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha